

MAYE MUSK

ÇDO GRUA DUHET TË BËJË PLANE

KËSHILLA PËR NJË JETË PLOT AVENTURA DHE SUKSESE

BOTIMET TOENA

MAYE MUSK

ÇDO GRUA DUHET TË BËJË PLANE

KËSHILLA PËR NJË JETË PLOT AVENTURA DHE SUKSESE

Përktheu nga origjinali anglisht

Maniela Sota

BOTIMET TOENA

Autori: Maye Musk

Titulli në original: A women makes a plan

Botoi në anglisht: Viking Life, markë tregtare e Penguin Random House LLC

Botuese: Irena Toçi

Redaktor letrar: Eris Rusi

Korrektore letrare: Majlinda Bami

Përkujdesja grafike: Elsa Hajderaj

Foto e kopertinës *nga* Fadil Berisha

Fotot e librit: nga albumi i familjes së autores

ISBN 9789928960122

© 2019 by Maye Musk Inc.

© në shqip BOTIMET TOENA

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 67 70 70 884

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al>

Dua t'ua kushtoj këtë libër atyre njerëzve
që kanë pasur më shumë ndikim në jetën time:

Nënës sime të ndjerë, Uin Haldeman, e cila më ka dhënë mua,
motrave të mia dhe çdo gruaje që ka takuar në jetë vetëbesimin
se do t'ia dalim mbanë.

Motrës sime të ndjerë, Lin Haldeman, e cila më dëgjoi për të gjitha
përpjekjet që kam bërë çdo natë për pesë vjet me radhë
dhe më inkurajoi gjatë gjithë procesit gjyqësor kundër pronarit
të godinës ku jetoja për të riparuar oxhakun e saj.

Motrës sime binjake, Kaje, e cila më ka mbrojtur gjatë gjithë jetës
dhe më ndihmon që të jem me këmbë në tokë.

Toskës, vajzës sime të dashur, Ilonit dhe Kimbalit, dy djemve të mi,
të cilët më respektojnë dhe më mbështesin në gjithçka që bëj.

Njëmbëdhjetë nipërve të mi, të cilët më bëjnë të vijoj të mësoj
ende dhe më sjellin shumë gëzim me të gjitha pyetjet e tyre.

Familjes sime të madhe, miqve dhe ekipit, të cilët më kanë mbështetur
si në kohërat e vështira, ashtu edhe në ato të mira dhe vazhdojnë
ta bëjnë këtë edhe në të tashmen.

PËRMBAJTJA

HYRJE:

JETO ME RREZIKUN, POR TREGOHU E KUJDESSHME: Bëj një plan dhe provo fatin 11

Pjesa 1: Bukuria

- 1 *NGJYRA PLATIN ËSHTEË BIONDJA E RE: Jeta bëhet gjithnjë e më e mirë 17*
- 2 *BËHU MAGJEPSËSE: Është më mirë të jesh interesante sesa e bukur 27*
- 3 *MODELE E SHKËLQYER, POR VESHJA LË PËR TË DËSHIRUAR: Nuk duhet të ndjekësh modën patjetër; mjafton të gesh një shoqe që e bën këtë 31*
- 4 *E DUA MAKIJAZHIN DHE MAKIJAZHI MË DO MUA: Makijazhi mund të të ndryshojë pamjen izike dhe gjendjen shpirtërore 39*
- 5 *LOJËRAT E BESIMIT NË VETVETE: Mbaj kokën lart dhe tregohu e sjellshme 43*

Pjesa 2: Aventurat

- 6 *SEZONI I XHAKARANDAVE: Ndiq rrugën tënde 49*
- 7 *EKSPLORIMI: Bëj plane për gjëra të pritshme dhe përgatitu për gjëra të papritura 58*
- 8 *PSE JO?: Thuaji “po” të gjitha mundësive 65*
- 9 *GRUAJA DUHET TË BËJË PLANE: Merre jetën në duar dhe syno lumturinë 70*
- 10 *NDRYSHOJE JETËN RRËNJËSISHT: Merru me problemet që ke 84*

Pjesa 3: Familja

- 11 *NJË NËNË QË PUNON: Udhëhiq duke dhënë shembullin tënd 93*

- 12 *MAGJIA E NUMRIT DYMBËDHJETË*: Nëse fëmijët tregojnë interes, jepu zemër 99
- 13 *SI TA NISËSH NGA FILLIMI*: Thuaji “Po” një jete interesante 105
- 14 *ZHVENDOSU NË NJË VEND TJETËR, NËSE ËSHTË E NEVOJSHME*: Provo fatin; në vendin tënd mund të kthehesh kur të duash 110
- 15 *GJESTE MIRËSIE*: Vlerëso gjërat e mira 115

Pjesa 4: Suksesi

- 16 *GRUAJA QË PUNON*: Sa më shumë të punosh, aq më shumë fat do të kesh 123
- 17 *KËRKO ATË ÇKA DËSHIRON*: Këmbëngulja të çon te suksesi 127
- 18 *NDIHU SHKËLQYESHËM*: Mos u zhyt në zhgënjime 131
- 19 *EC PËRPARA*: Fillimi nga e para mund të jetë gjëja më e mirë që mund të bësh 139
- 20 *DIL NGA NATYRA JOTE*: Tejkalo kufijtë e tu 146
- 21 *E FAMSHME NË INSTAGRAM*: Nuk je asnjëherë tepër e vjetër në moshë për të mësuar një teknologji të re 151
- 22 *ZONJAT BEQARE*: Mund të jesh e lumtur në dashuri, por mund të jesh e lumtur edhe pa njeri në krah 156

Pjesa 5: Shëndeti

- 23 *USHQYERJA E MIRË TË BËN TË LUMTUR*: Planifiko vaktet 165
- 24 *GËZOJU USHQIMIT PËRSËRI*: Nuk ekziston asnjë pilulë magjike 177
- 25 *ÇOKOLLATAT LARGOHEN NGA SHTËPIA BASHKË ME MYSAFIRËT*: Mbajti tundimet larg vetes 183
- 26 *BËJ LËVIZJE*: Zgjidh aktivitete që të pëlqejnë 187
- 27 *RRI ME NJERËZ TË LUMTUR*: Marrëdhëniet e shëndetshme të bëjnë shumë mirë 192
- 28 *ËSHTË E MREKULLUESHME TË JESH SHTATËDHJETË E NJË VJEÇ*: Buzëqesh gjithmonë! 196

KONKLUSIONI 202

BËJ NJË PLAN: *Fillo tani* 202

Falënderime 205

Për Autoren

HYRJE

JETO ME RREZIKUN, POR TREGOHU E KUJDESSHME:

Bëj një plan dhe provo fatin

Urrita në një familje, ku të gjithë ishim të dhënë pas eksplorimeve dhe udhëtonim gjithmonë me avionin e babait. Prindërit e mi shkuan në Kanada, Amerikë, Afrikë, Evropë, Azi dhe Australi me atë avion të vogël me helika, pa GPS dhe pa radio. Kur ishim fëmijë, bënim çdo vit ekskursione në shkretëtirën e Kalaharit, në kërkim të qytetit të humbur. Duke hedhur vështrimin pas, e kuptoj se sa e rrezikshme ishte të ecje nëpër shkretëtirë me pesë fëmijë dhe duke pasur vetëm një busull dhe rezerva ushqimi e uji për tre javë. Por prindërit e mi i planifikonin ekskursionet deri në detajin më të vogël. Motoja e familjes sonë ishte: “Jeto me rrezikun, por tregohu i kujdesshëm”. Babait tim i pëlqenin aventurat, por edhe ishte i përgatitur se çfarë duhej të bënte nëse ndodhte diçka e papritur. Prandaj, edhe unë jam gjithmonë kureshtare dhe kam dëshirë të eksploroj. Dhe e di që mund ta marr përsipër një risk nëse jam e përgatitur.

Afrikanët kanë një shprehje me të cilën jam rritur edhe unë: “’n Boer maak ’n plan”. Fjalë për fjalë përkthehet “Fermeri ecën me plane”. Banorët e Afrikës së Jugut e përsërisin shpesh këtë shprehje. E thonë kur bëhet fjalë për gjëra të vogla, por edhe për gjëra shumë të mëdha. Ne e përdornim sa herë që duhet të gjenim zgjidhje për ndonjë problem. Çdo pengesë që njeriu ndesh në jetë, duhet ta trajtojë me përgjegjshmëri dhe të gjejë një mënyrë për ta kapërcyer.

Në fillim, këtë libër doja ta titulloja *Struggling and Surviving* (Luftë dhe mbijetesë), por askujt nuk iu duk titull interesant. Shpresoj që, pasi

ta lexosh këtë libër, të përpiqesh më pak se unë dhe të kesh më shumë forcë për të mbijetuar sesa unë. Në jetë, shumë shpesh gjërat nuk më kanë shkuar mirë dhe çdo herë më është dashur të bëj një plan. Duke qenë grua, ti bën shumë plane për gjëra të ndryshme, por pastaj e shikon se t'i kanë prishur ato dhe të duhet të bësh të tjera. (Meqë ra fjala, kjo u ndodh edhe burrave, gjithashtu.)

E kam nisur jetën nga fillimi shumë herë dhe që kur arrita moshën madhore kam jetuar në nëntë qytete, në tre shtete të ndryshme. Nuk ta rekomandoj që t'ia nisësh nga fillimi sërish e sërish, ashtu siç kam bërë unë, por nëse të duhet ta bësh, duhet të kesh një plan të qartë të përcaktuar paraprakisht. Kur provon fatin, mund të bësh një jetë më interesante dhe më të lumtur. Unë rrezikova shumë herë dhe në fillim jam përpjekur shumë, por u tregova këmbëngulëse derisa arrita suksesin në jetën personale dhe në atë profesionale. Nuk të duhet patjetër të planifikosh çdo detaj të ndryshimeve të jetës; mund t'i zgjidhësh problemet kur ato të shfaqen. Dhe, sigurisht, do të shfaqen probleme të ndryshme. Por, duhet ta planifikosh hapin e parë.

Jeta të ofron surpriza në çdo moment. Nga kujdesi për veten, familjen dhe miqtë e tu, deri te pamja e jashtme dhe të ndjerit shkëlqyeshëm dhe deri tek të pasurit e një karriere të suksesshme dhe të jetuarit e një jete plot aventura, ka shumë e shumë gjëra për të cilat duhet të mendosh në të njëjtën kohë. Por, nëse bën hapin e parë dhe pastaj edhe një tjetër, me siguri do të vazhdosh të ecësh përpara.



Kur jam ndodhur në situata të vështira, lexoja shumë romane dashurie ose libra motivues. Ato më jepnin shpresë. Ndoshta vetë fakti që po i ndaj përvojat e mia me ty, do të të japë shpresë.

Është diçka fantastike të arrish moshën time. Kam jetuar shtatë dekada, kam shijuar dy karriera të suksesshme dhe kam rritur tre fëmijë. Jam gjyshe dhe kam njëmbëdhjetë nipër e mbesa. Dhe tani, jam më e kërkuar se kurdoherë tjetër për të qenë folëse motivuese dhe fotomodele.

Madje, të tjerët më kërkuan të shkruaja këtë libër! Prandaj them se është fantastike të jesh shtatëdhjetë e një vjeç! Zgjohem gjithmonë plot entuziazëm për ditën e re.

Nëse ke një qëndrim pozitiv, bën një plan dhe provon fatin, mund të shkosh edhe në Mars.

PJESA E PARË



Bukuria

NJË

NGJYRA PLATIN ËSHTË BIONDJA E RE

Jeta bëhet gjithnjë e më e mirë



Në moshën pesëdhjetenëntëvjeçare hoqa dorë nga lyerja e flokëve dhe i lashë me thinja, ngjyrë platini. Pas dy vjetësh, dola shtatzënë në kopertinën e revistës New York. (Sigurisht, nuk isha vërtet shtatzënë, por fotografia dukej mjaft bindëse.) Kur isha gjashtëdhjetë e shtatë vjeç, dola për herë të parë në sfilatën e një shfaqjeje mode të organizuar në kuadër të *New York Fashion Week*, bashkë me femra të tjera që ishin një e treta e moshës sime. Në moshën gjashtëdhjetenëntëvjeçare, u bëra imazhi i kompanisë *CoverGirl*.

A mund t'i imagjinosh të gjitha këto? Mua ende nuk më besohet. Nuk do ta kisha menduar asnjëherë se flokët ngjyrë gri do të ishin sekreti për t'u bërë supermodele. Për herë të parë sfilova si modele në podiumin e një shfaqjeje mode kur isha pesëmbëdhjetë vjeç dhe më thanë se, në moshën tetëmbëdhjetëvjeçare karriera ime do të merrte fund. Si modele, nuk e prisja që të zgjaste kaq shumë dhe sigurisht kurrsesi deri në moshën e nderuar shtatëdhjetenjëvjeçare. Por, ja ku jam, pesëdhjetë e gjashtë vjet më vonë dhe jam ende në fillimet e mia.

Femrat nuk duhet ta ngadalësojnë ritmin teksa ikin vitet. Unë vetë jam duke ecur me shpejtësi plumbi. Përpiqem të eksploroj sa më shumë gjëra, të argëtohem, të punoj më shumë se kurrë, të jem aktive në rrjetet sociale për t'u siguruar se jam më e pranishme se kurrë dhe po i gëzohem

jetës si asnjëherë më parë. E thashë që po argëtohem? Nëse burrat nuk duhet ta ngadalësojnë ritmin, atëherë as ne, gratë, nuk duhet ta bëjmë këtë. Mos e lër moshën që të të ngadalësojë ritmin apo të të pengojë për të ecur përpara. Kujdesu për veten sa më mirë të mundesh duke ngrënë mirë, duke buzëqeshur dhe duke qenë aktive, e lumtur dhe me besim në vetvete. Unë nuk kam pasur asnjëherë frikë nga plakja. Më vjen për të qeshur tani kur shikoj rrudhat në fytyrë dhe, pas moshës gjashtëdhjetë vjeç, edhe ato në ije dhe në krahë. Më duken të lezetshme. E vërteta është që jam jashtëzakonisht tejet e lumtur që jam mirë me shëndet.



Fillova punën si modele në adoleshencë, kur isha në Pretoria, në Afrikën e Jugut, sepse një nga miket e prindërve të mi kishte një shkollë dhe agjenci mode. Emri i saj ishte Leti dhe i shoqi i saj kishte një avion, ashtu si babai im. Çdo të diel në mbrëmje ata darkonin me familjen tonë. Leti ishte shumë e bukur, e hijshme dhe kishte besim të fortë në vetvete, edhe pse nuk e shprehte, çka të bindte për të bërë gjithçka që të kërkonte ajo.

Kur unë dhe motra ime binjake Kaje ishim pesëmbëdhjetë vjeç, Leti na ofroi mundësinë që të ndiqnim falas kursin e modës te shkolla e saj, gjë të cilën e bëmë pa u menduar shumë. Për sfilatën e fundit, në të cilën do të merrnim edhe diplomat, bëra një kostum ngjyrë rozë në stilin e *Chanel*-it. Flokët i leva ngjyrë gështenjë dhe makijazhin e bëra vetë.

Leti ishte ajo që më angazhoi për herë të parë edhe si modele. Merrja pjesë në sfilata mode të shtunave në mëngjes në një qendër tregtare, ose pozoja për revista. Nuk ndihesha e veçantë ose e privilegjuar ngaqë isha modele. Ishte thjesht një punë. Pagesa ishte më e madhe sesa në shumë të tjera dhe kjo ishte gjë e mirë, por, kur e mora vesh këtë, u habita. Shkoje diku, vishje një fustan, bëje një xhiro në sallë dhe ktheheshe në shtëpi. Pse duhej paguar mirë një punë e tillë? Por, ja që paguhej, sidomos për vajzat e moshës sime.

As nuk më shkonte mendja se do të isha modele edhe në moshën shtatëdhjetë e një vjeç. Mjaftonte të hidhje një herë sytë vërdallë dhe të kuptoje se të gjitha modelet ishin shumë të reja. E dija që ishte diçka e

përkohshme dhe kjo nuk më bezdiste aspak. Isha thjesht e kënaqur të fitoja ca para. Synimi im nuk ishte të bëhesha modele, por të shkoja në fakultet.

Për habinë time, vazhdova të punoja si modele edhe në fakultet. Ashtu siç e kisha planifikuar, mora diplomën. Pastaj, një surprizë tjetër: u martova. Nuk e kisha ndër mend të bëhesha shpejt me fëmijë. Nuk ma merrte mendja se do të mbetesh shtatzënë që në muajin e mjaltit dhe do të lindja tre fëmijë brenda tre vjetësh. Iloni, Kimbali dhe Toska ishin tre surpriza të tjera. Pas çdo fëmije, shtoja fije bionde në flokët e mi. Pas Toskës, isha komplet bionde.

Fillova sërish të punoja si modele pas lindjes së tre fëmijëve, sepse Leti më kërkoi përsëri. Agjencisë së saj i duhej dikush për rolin e nënës së nuses në disa shfaqje mode dhe këtë nuk mund ta bënte një tetëmbëdhjetëvjeçare. Të gjitha vajzat e tjera ishin tepër të reja. Ndaj më tha mua, meqenëse isha njëzet e tetë vjeç. Në këtë mënyrë, u bëra modelja më e madhe në moshë në Afrikën e Jugut.



Në moshën tridhjetenjëvjeçare, isha një nënë e vetme dhe u zhvendosa në Durban, pasi po mundohesha të fshihesha nga bashkëshorti im. Nuk kisha më aq para sa të paguaja dikë për të më lyer flokët, kështu që fillova t'i lyeja vetë dhe ata morën nuanca mes biondes dhe portokallisë. *Blorange*¹, siç e quajnë disa. Dukeshin shumë shëmtuar. Fijet e flokëve ishin shumë të çrregullta dhe unë i shkurtoja vetë për të kursyer para. Nuk e di pse, por vazhdonin të më kërkonin për modele, kështu që nuk kisha pse të merakosesha. Ky angazhim, gjithsesi, nuk më prishte punë për studion e nutricionit, të cilën e kisha hapur që në moshën njëzetedyvjeçare në apartamentin tim në Pretoria. Për sa kohë arrija t'i ndihmoja klientët e mi, ata nuk donin t'ia dinin sesi i kisha flokët.

Në moshën dyzetedyvjeçare, kur u zhvendosa në Toronto, rifillova studimet për të mbrojtur doktoraturën, ndërkohë që punoja si modele

¹ Nga bashkimi i “blonde” dhe “orange”. (shën. i përkth.)

dhe si nutricioniste. Kisha një portofol të mirë si modele, i cili më siguronte punë në çdo kohë. Në atë kohë, një agjenci në Toronto donte të më angazhonte, pasi menaxherët e saj mendonin se mund të bënin shumë para me mua. Shumica e vendeve të punës për modele ishin për femra më të reja, por ndonjëherë u duhej ndonjë modele më në moshë për t'u dukur më realiste. Pikërisht atëherë mora pjesë për herë të parë në një reklamë në rolin e gjyshes dhe dola në kopertinë. Isha vetëm dyzet e dy vjeç!

Sigurisht unë nuk isha e vetmja modele dyzetvjeçare në Toronto. Edhe pse zakonisht isha personi më i madh në moshë i një ekipi me adoleshente dhe njëzetvjeçare, nuk ndodhte gjithmonë kështu. Mos të harrojmë që, nuk po flas për modën e lartë apo *haute couture*. As për javën e modës në Nju-Jork apo në Milano.

Mbaj mend që, një herë isha në një sfilatë ku merrnin pjesë vetëm femra dhe meshkuj në moshë. Pas shfaqjes, dolëm së bashku të gjithë për të pirë diçka. Njëri nga burrat më tha:

- Do të të duhet ta paguash vetë pijen që more, sepse je e vetmja që nuk ke shkuar me mua.

E vështrova, por nuk nxora asnjë fjalë.

Ai vazhdoi:

- Po, është e vërtetë. Kam bërë reklama dyshekësh me të gjitha modelet e tjera.

Ky ishte lloji i punëve vakante për modelet më në moshë: reklama për dyshekë dhe gjëra të tjera të ngjashme.

Por, unë nuk doja t'ia dija, sepse nuk ndodhesha aty ngaqë ishte punë interesante. Ishte thjesht një punë dhe duhej të punoja. Vazhdova të punoja si modele, sepse ishte diçka argëtuese, më mbante në formë dhe më bënte të dilja shpesh nga zyra, duke më dhënë mundësinë që të vizitoja qytete të ndryshme dhe të takoja njerëz të tjerë. Në gjithë ato vite, kërkoja që të më programonin tre javë përpara në mënyrë që të mos ndërprisja punën në zyrë dhe nuk doja të punoja si modele më shumë se katër ditë në muaj. Nga kjo punë fitoja po aq para sa edhe nga studioja ime ku zhvilloja konsulta si nutricioniste. Kjo e dyta ishte puna ime bazë, nga e cila kisha të ardhura vazhdueshme dhe nuk kisha

ndër mend që ta rrezikojë - me atë mbulojë shpenzimet e përditshme, qiranë, biletat e autobusit, uniformat shkollore të fëmijëve dhe makinën. Puna si modele më jepte mundësinë që të blija bileta të lira avioni për të shkuar te prindërit, për të blerë rroba ose gjëra të ndryshme që më duheshin për shtëpinë. Ndonjëherë blija ndonjë fustan. Modelingu ishte qershia mbi tortë.

Klientëve të studios nuk u thosha që merresha me sfilata dhe, ngaqë atëherë nuk ekzistonin rrjetet sociale, askush nuk e dinte.

Ndonjëherë, më pyeste ndonjëri:

- Je ti ajo te filan revistë?

- Po. Jam mbretëresha e rrobëdhomave të *Sears*, - i përgjigjesha unë.

Kjo ishte puna ime. Nëse *Sears* donte të bënte reklamë për rrobëdhoma, më kërkonin mua që t'u shiteshin sa më shumë.



Kur isha në të pesëdhjetat, jetoja në Nju-Jork. Kisha marrë pjesë në disa fushata të shkëlqyera, pastaj kisha nënshkruar një kontratë me një agjenci më të madhe, sepse mendoja që kjo gjë do të më bënte më të dukshme. Por, ndodhi krejt e kundërta. Nëse më përpara merresha herë pas here me modeling, tani nuk po merresha pothuajse fare.

U dërgoja *e-mail*-e, në të cilat u thosha se kisha nënshkruar një kontratë për të punuar si modele. Ata më përgjigjeshin se nuk kishin punë për mua.

Atëherë, i merrja në telefon. Dhe më thoshin:

- Është fare e thjeshtë. Njerëzit nuk duan të të shikojnë ty. Preferojnë modele të tjera, të cilat janë më të njohura.

“Por as ato nuk janë aq të njohura”, thosha me vete.

Nuk mund ta kuptoja pse klientët nuk donin të punonin më me mua. Kisha punuar si modele për dhjetëra vite, por ndoshta kishte ardhur momenti që të ndalesha. Më thanë që askujt nuk i pëlqente më pamja ime.

Për fat të mirë, takohesha ndonjëherë me njerëz, të cilët punonin në këtë fushë. Më ndalonin në rrugë ose në ndonjë restorant dhe më thoshin:

- Jemi përpjekur të të kontaktojmë për punë, por asnjëherë nuk ke qenë e disponueshme.

Shkoja tek agjencia dhe u thosha që shumë njerëz kanë dashur të më kontaktojnë.

- Jo, - më thoshin, - nuk është e vërtetë. Të ngatërrojnë me ndonjë tjetër.

Pikërisht atëherë vendosa që të mos i lyeja më flokët. Mendova: “Meqë s’po merrem më me modeling, me këtë rast po shikoj edhe cila është ngjyra ime natyrale.”.

Flokët filluan të më rriteshin dhe dukeshin si mos më keq. Ishin të bardhë në rrënjë dhe biondë në gjatësinë e tyre mbi supe. Kur je dietologe, nuk ka rëndësi se çfarë ngjyre i ke flokët për aq kohë sa je e zonja në punën që bën. Dëgjova këshillën e mikes sime më të mirë, Xhulia Perri, dhe i preva flokët shumë shkurt. Ishte një ndryshim i guximshëm dhe dukeshin mjaft tërheqëse. Nuk kisha bërë asnjëherë më parë diçka të tillë.



Pasi qëndrova me flokë krejt të thinjur, agjencia nuk më kontaktoi më për gjashtë muaj me radhë. Ishte një periudhë shumë e vështirë. Filloi të më dukej sikur nuk ekzistonte më asnjë mundësi për mua. Ndoshta ky ishte fundi i karrierës sime si modele.

Pastaj ndodhi diçka interesante. Një drejtoreshë që merrej me përzgjedhjen e stafit telefonoi agjencinë dhe u kërkoi që të më angazhonin mua për revistën *Time*. Kësaj here, agjencia nuk mundi të thoshte se isha e zënë, pasi zyra e drejtoreshës ishte vetëm një rrugë larg shtëpisë sime dhe ajo më shikonte përditë në mëngjes kur nxirrja qenin shëtitje.

Kështu, atyre iu desh të më merrnin për këtë punë dhe unë dola në revistën *Time*, në faqen e parë të rubrikës së “Shëndetit”.

Kuptova se ende ekzistonin mundësi për mua. Problemi nuk ishte paraqitja ime. Ishte vetë agjencia.

Më duhet të bëja një plan.



Njerëzit kanë interesat e tyre të fshehta. Doja të shfrytëzoja të gjitha mundësitë që kisha për punë. Agjentët e mi duhet të më promovonin karrierën, por, për arsye të caktuara, nuk po e bënin këtë. Sapo e kuptova këtë gjë, vendosa se duhet të bëja diçka. Nuk mund të rrija duarkryq dhe t'i lejoja të tjerët të më privonin nga punët.

Shkova tek agjencia për t'u thënë ato që mendoja, sepse, nëse dëshiron diçka, duhet ta kërkosësh atë.

Agjentja ime ishte gjithë nerva.

- Si guxon të mendosh se ne nuk po përpiqemi mjaftueshëm për ty?!

Ajo po gënjente. Dhe të dyja e dinim mirë këtë gjë. Është diçka krejt tjetër të shkosh në një konkurs dhe të mos e fitosh. Kjo më kishte ndodhur shumë e shumë herë. Shkon diku dhe pret në radhë bashkë me njëzet vajza të tjera dhe, në fund, nuk e fiton një punë të caktuar. Këto janë sfidat e profesionit të modeles. Dhe është diçka krejt tjetër që agjencia me të cilën ke kontratë të mos të të dërgojë fare në konkurse përzgjedhjeje - kjo nuk është aspak gjë e mirë. Por, ata refuzonin ta pranonin këtë. Vazhdonin të këmbëngulnin se nuk kishte punë. Kisha mbetur e bllokuar në vend, sepse kisha nënshkruar një kontratë me ta.



Kur je në një situatë të vështirë në punë, e cila nuk mund të ndryshojë dhe nga e cila nuk mund të dalësh, nuk je e sigurt se çfarë do të ndodhë në vijim. Është e frikshme. Sepse çdo ditë pune do të jetë e tmerrshme. Nëse nuk ke asnjë gëzim, dita jote do të jetë e trishtueshme. Duhet ta presësh me dëshirë çdo ditë pune dhe ta duash atë që bën, sepse shumicën e kohës e kalojmë duke punuar. Në studion time të nutricionit, vinin shumë avokate, të cilat, megjithëse e pëlqenin punën, kishin probleme me shefat e tyre. E di mirë këtë, sepse trishtimi dhe stresi i bënin të hanin keq. U sugjeroja ta ndryshonin situatën. Dhe shumë prej tyre, e bënin këtë: aplikonin dhe fillonin punë në një studio tjetër avokatie, ose hapnin zyrën e tyre të avokatisë. Dhe kështu, ishin më të lumtura

dhe hanin më shëndetshëm. Klientet më thoshin gjithmonë se konsultat me mua kushtonin më pak dhe ishin më të dobishme sesa ato me një psikolog.



Lexova me kujdes kontratën time si modele dhe vura re se ishte e vlefshme vetëm për qytetin e Nju-Jorkut. Kështu që, kontaktova disa agjenci në Filadelfia, Hamptons, Konektikat, Nju-Xhersi, Los Anxhelos, Hamburg, Mynih, Paris, Londër. Nënshkrova kontrata me të gjitha prej tyre dhe fillova të kisha ca punë. Shkoja në Europë për të pozuar për katalogë të ndryshëm, për revista ose për të bërë reklama për produkte flokësh ose produkte farmaceutike. Më paguanin mirë, por gjithmonë udhëtoja në klasin ekonomik dhe bëja shpenzime të kufizuara.

Në disa qytete afër, pozoja për katalogë, reklama dhe sallone. Nuk ishte ndonjë kushedi se çfarë, por ishte punë. Duhet të bëja prezantime veshjesh për klientë të dyqaneve të lira. Kisha një kabinë të vogël prej kartonxhesi kur ndërrohesha dhe pastaj dilja për të bërë prezantimet. Ishin rreth tridhjetë njerëz që më shikonin duke sfiluar me veshje të ndryshme. Sa herë shkoja në kabinë për t'u ndërruar, merrja vetëm një kafshatë nga *bageli* me djathë që kisha aty, sepse nuk kisha kohë ta haja të gjithin.

Gjithsesi, shumica e punëve ishin në Nju-Jork dhe agjencia me të cilën kisha kontratën vazhdonte të m'i bllokonte ato mundësi. E dija se mund t'ia dilja shumë më mirë. E dija se mosha dhe paraqitja ime nuk ishin pengesë. Fajin e kishin ata, jo unë!

Duhet të gjeja një mënyrë për të dalë nga kjo gjendje. Kështu që, shkova tek ata, u ula në hollin e pritjes dhe prita e prita derisa pranuan që të flisja me drejtuesen e agjencisë.

- U bënë gjashtë muaj që nuk më keni dërguar në konkurse, - i thashë unë. - Duhet të më lejoni që të shkëputem nga kontrata me ju.

Isha e vendosur që të mos largohesha që aty derisa të merrja atë çka doja, kështu që më në fund pranuan. Duhet ta kisha bërë që më parë këtë gjë. Të këshilloj që ta mësosh këtë gjë më shpejt sesa e mësova unë dhe

do të vuash më pak. Nëse e shikon se nuk do të ndryshojë asgjë, largohu sa më shpejt që të jetë e mundur, edhe sikur të mos kesh të rregulluar asgjë për më pas ose mendon se nuk do të gjesh punë. Largohu edhe sikur të jesh ngushtë financiarisht më pas.



Pas kësaj, u angazhova në një agjenci të vogël me të cilën kisha bashkëpunuar edhe më parë. Ata ishin të entuziazmuar që do të punonin me mua dhe u pëlqente pamja ime e re. Më dërguan të pozoja për një reportazh fotografik në Toronto, gjë që ishte diçka e shkëlqyer për mua, sepse, me kalimin e viteve, askush nuk të do më për faqe të para. Të pozoje për një reportazh ishte diçka fantastike. Vetëm se unë nuk isha fantastike. Nuk e kisha aspak idenë sesi të pozoja për një reportazh fotografik!

Për katalogët, je e shtendosur, në formë dhe nuk duhet t'i zhubrosësh rrobat. Nuk mund t'i prezantosh ato sikur po bën shaka. Ndërsa, në një editorial, papritur e shikon se mund të hidhesh dhe të kërcesh, të shtriqesh dhe të bësh gjëra të çmendura. Duhet të mësoja, kështu që fillova të shikoja revistat.

E vetmja përvojë e ngjashme me reportazhin pat qenë kur isha dyzet e pesë vjeç dhe në atë sesion fotografik nuk kisha qenë veçse një sfond për supermodelen që prezantonin në revistë.

Shkova me avion për në Toronto. Isha e vetmja modele që merrte pjesë në atë seancë fotografike.

- Ku janë modelet e tjera? - pyeta.

- Ti je e vetmja, - m'u përgjigjën.

Kështu, u zgjova në botën krijuese të veshjeve të bukura, të firmave, *couture*. Pozova për tetë faqe me veshje të bardha. Ishte një rrëfim "i bardhë" dhe shumë i bukur. Një stil flokësh i ndryshëm çdo herë, edhe pse flokët i kisha të shkurtra.

Kur pashë fotografitë, gjithçka që mund të thosha ishte: "Uau!".

Pastaj, fillova të merrja oferta pune. Kur u zhvendosa për herë të parë në Nju-Jork, bashkë me Kimbalin shkuam në "Times Square" dhe,

duke parë reklamat gjigande mbi ne, i thashë: “Një ditë do të jem edhe unë aty.”. Qeshëm të dyja. Dhe ja që, tani isha pikërisht aty: për herë të parë në një reklamë katër metra të lartë në “Times Square”.

Kisha shkuar në një konkurs për një reklamë për *Virgin America* bashkë me treqind femra të tjera dhe më zgjodhën mua. Në seancën fotografike ishin gjithashtu edhe dy modelë të rinj, një vajzë dhe një djalë, tepër mendjemëdhenj për të shkëmbyer ndonjë fjalë me mua. E megjithatë, në reklamën finale, unë isha fytyra që të kapte syri që në fillim. Në moshën gjashtëdhjeteshtatëvjeçare, isha kudo: në “Times Square”, në metro dhe në çdo aeroport të Amerikës. Nga çfarëdolloj treni apo avioni po të zbrisje, do të shikoje fytyrën time.

Kujt do t’i shkonte në mendje se gjërat do të fillonin të ecnin kur unë të bëhesha me flokë ngjyrë platini?! Në moshën pesëmbëdhjetëvjeçare, më kishin thënë se jeta ime profesionale si modele do të merrte fund kur të bëhesha tetëmbëdhjetë, por në moshën shtatëdhjetë e një vjeç jam më e famshme se kurrë. Ajo çka kam mësuar është se, gjithmonë mund të gjesh një zgjidhje. Gjithmonë mund të bësh një plan tjetër. Sigurisht, m’u desh shumë kohë që ta mësoja këtë dhe vazhdoj të mësoj!

Ka ndodhur edhe diçka tjetër, e cila ka qenë një surprizë e jashtëzakonshme për mua. Rrjetet sociale! Nëpërmjet postimeve që bëja, njerëzit u dashuruan me flokët e mi të bardhë dhe nënshkrova shumë kontrata modelingu falë kësaj ngjyre flokësh. Tani ndihem shumë mirë kur futem në një ambient duke e ditur se jam i vetmi person me flokë të bardhë. Nëse ndodh të ketë edhe ndonjë grua tjetër me flokë të bardhë, gjithmonë buzëqesh dhe them: “Si dy pika uji!”.

Jam e sigurt vetëm për një gjë: jeta bëhet gjithnjë e më e mirë. Çdo të hënë, më entuziaste se kurrë, sepse pres që të kënaqem në punë. Edhe nëse nuk ndodh kushedi se çfarë, jam përsëri e entuziazmuar, sepse mund të bëj postime në rrjete sociale dhe faqe interneti dhe kjo më jep kënaqësi. Prandaj them se është diçka e mrekullueshme të jesh shtatëdhjetë e një vjeç. Prandaj nuk shqetësohem për moshën.

Jam tepër e zënë duke u kënaqur me gjithçka bëj.

DY

BËHU MAGJEPSËSE

Është më mirë të jesh interesante sesa e bukur



Isha mbi pesëdhjetë vjeç kur shkova në një konkurs për reklama produktesh kozmetike.

- Je kaq e bukur! - më tha drejtori i konkursit.

- E po, ky është kushti paraprak, apo jo? - vazhdova unë.

Arsyeja pse kisha vajtur ishte pikërisht për një fushatë reklamash për produkte kozmetike. Mendova se replika ime ishte gazmore, sepse, duke u rritur në Afrikën e Jugut, isha mësuar me faktin që njerëzit e zhvlerësonin shumë veten.


Të gjithë mbetën të habitur. Ajo që kisha thënë nuk iu duk aspak për të qeshur... As nuk më morën fare në konsideratë për atë punë, sepse isha treguar tepër e pacipë.

Pas kësaj ndodhie, mësova të them vetëm “Faleminderit!”.



Nuk e kam kuptuar asnjëherë pse në Amerikë të gjithë njerëzit flasin për bukurinë fizike. Në Afrikën e Jugut, vlerësohesh më shumë si femër nëse je inteligjente, interesante dhe ke sens të zhvilluar humor. Pamja e jashtme ka më pak rëndësi. Njerëzit më thoshin se kisha shumë humor.

Dhe unë mendoja se kisha vërtet. Dhe kështu mendoj akoma. Ishin shumë më të interesuar për punën time si dietologe, që isha gjithmonë e përditësuar me të rejat e kësaj fushe dhe që mbaja fjalime. Dhe që isha e angazhuar në media. Dhe që kisha kabinetin tim. Ishin më të interesuar për etikën që kisha në punë dhe për profesionalizmin tim.



Kur shkova për herë të parë në Amerikë, mora në telefon motrën time binjake, Kajen, dhe i fola për sjelljen e çuditshme amerikane në lidhje me aspektin e bukurisë.

Kaja është një nga njerëzit e mi më të dashur. Flasim çdo mbrëmje dhe ajo është gjithmonë e sinqertë me mua. Ajo është personi, të cilës i kërkoj këshilla në lidhje me çdo gjë, që nga investimet deri te fasetat dentare (ajo më ka thënë që të mos vendos të tilla dhe ta lë këtë muhabet). Ka qenë gjithmonë pranë meje dhe më ka mbështetur gjithmonë.

Gjëja më e mirë që ka Kaja është fakti që është e drejtpërdrejtë dhe nuk merret me kotësira. Thjesht thotë atë që mendon.

Kjo nuk do të thotë që është një njeri hijerëndë. Kaja qesh gjatë gjithë kohës dhe, nga ne të dyja, është më gazmorja. Veçse nuk përpiket të kënaqë askënd, veçse veten e saj. Rezultati është që njerëzit e duan shumë dhe i mblidhen përreth, atëherë kur ajo fillon të flasë. Edhe ti po ta takoje, do ta pëlqeje menjëherë. Nga momenti që dikush takohet me Kajen, unë mund të tërhiqem fare mirë në një cep dhe të filloj të punoj me shtiza. Por për fat të keq, nuk do të mund ta takosh asnjëherë, sepse ajo rri shumë e vetmuar.



Kaja më thoshte: “Njerëzit gjithmonë kanë menduar se je e bukur, edhe nëse nuk e kanë shprehur këtë. Kur hyje ti në dhomë, të gjitha shikimet drejtoheshin nga ty.”.

Unë nuk e kisha vënë re këtë, sepse nuk shikoja askënd. Shikoja vetëm në drejtimin ku po ecja. Kjo më bëri të sillja në mendje disa meshkuj, me të cilët isha shoqëruar me kalimin e viteve, të cilët më kishin thënë: “Maje, kur të hyjmë në restorant, do të futesh ti e para?”.

Unë veproja kështu dhe ata vinin pas meje, në mënyrë që të gjithë njerëzit të shikonin se ne ishim bashkë. Sigurisht që, do të vinte momenti e të gjithë do të më braktisnin, sepse këtë bëjnë njerëzit që u intereson vetëm pamja e jashtme.

Duhet t’i kisha lënë unë e para. Kur takon një njeri të bukur, është e natyrshme që t’i gëzohesh shoqërisë së tij apo të saj. Por, nëse nuk është edhe interesant, do ta braktisësh shumë shpejt. Është më mirë që njerëzit të të pëlqejnë për personalitetin tënd sesa për bukurinë e jashtme.

Mbaj mend që kam takuar një herë një çift: ai ishte mjaft i pashëm, ndërsa ajo një femër shumë e zakonshme. Dukeshin një çift i çuditshëm. Deri në momentin që ajo filloi të fliste: ishte personi më tërheqës në dhomë, tamam si magnet.

Falë sjelljes së saj. Falë besimit në vetvete. Nëpërmjet mënyrës sesi e shikonte jetën. U bë një mike e mirë për mua, sepse ishte shumë inteligjente dhe me sens humori. Nuk “ngopesha” me të.

Njeriu mund të zgjedhë të ecë në rrugë të ndryshme, por unë do të preferoja që në pllakën e varrit tim më mirë të shkruhej “Ishte plot humor”, sesa “Ishte e bukur”.

Obsesioni me bukurinë e jashtme mund të krijojë pasiguri, sidomos nëse nuk ke pamje të përsosur. Mund të të bëjë të palumtur dhe të të pengojë në zhvillimin e shumë tipareve të tjera që janë vërtet me vlerë, si intelijenca apo avantazhi i të qenët tërheqës dhe interesante.



Këshilla ime është të jesh e mirë me të tjerët, t'i dëgjosh të tjerët dhe të jesh optimiste. Mos fillo të flasësh për jetën tënde të palumtur. Trego besim, respekt, interes për të tjerët dhe buzëqesh; kjo do të të bëjë të dukesh tërheqëse. Të gjithë kanë talente që mund t'i ndajnë me të tjerët. Nëse, në këtë moment mendon se nuk ke asnjë talent, kthehu në një moment të të kaluarës kur je ndjerë me vetëbesim për një aspekt të caktuar të jetës tënde. Fokuso tek ai aspekt, studioje, ndaje me të tjerët dhe bëhu shumë më interesante. Nëse ke një profesion, një hobi apo një interes të veçantë, lexo në lidhje me to dhe përmendi ato që di në bashkëbisedime. Tregohu entuziaste për të gjitha dhe do të jesh akoma më interesante dhe inteligjente. Nuk duhet të jesh e mirë në çdo gjë, por duhet të jesh e mirë në diçka të caktuar. Kur njerëzit më pyesin për receta, nuk mund t'i ndihmoj, sepse nuk jam kuzhinierë e mirë. Nuk ndihem keq për këtë gjë; thjesht nuk e kam talent dhe nuk jam e interesuar pas gatimit. Sigurisht, nuk kam ndër mend të eksperimentoj me lloje të reja gatimesh për të impresionuar të tjerët, nga momenti që nuk më pëlqen gatimi. Sigurohu që të jesh e zonja në diçka që të pëlqen.

Gjithashtu, përpiku të kultivosh sensin e humorit dhe të jesh më pak e ndjeshme ndaj atyre që thonë njerëzit. Kur një burrë dëshiron të dalë me mua dhe unë i them "Jo", ai më thotë se mund të gjejë në çdo kohë një femër më të re se unë. Unë vetëm qesh. Nuk dua t'ia di se çfarë mund të gjejë ai; ai njeri nuk më intereson dhe sigurisht që nuk do të mërzitem për këtë arsye.

Duhet të ecim përpara dhe të jemi të lumtur me atë që kemi. Nëse mund të bësh shaka, të qeshësh me veten dhe t'i bësh këto duke u treguar e shkujdesur, do të jesh më tërheqëse. Është e vështirë të mos flasësh për veten, sidomos nëse je duke kaluar një periudhë të vështirë, por duhet ta bësh këtë në një mënyrë të tillë që të zgjosh interesin e njerëzve.

TRE

MODELE E SHKËLQYER, POR VESHJA LË PËR TË DËSHIRUAR

*Nuk duhet të ndjekësh modën patjetër; mjafton të gjesh një shoqe
që e bën këtë*



Vishesha shik një ose dy herë në vit, për ditëlindjen time ose për ndonjë dasmë. Vetëm pasi kisha mbushur gjashtëdhjetë e shtatë vjeç dhe shkova në Met Ball, një gala madhështore mode, si e ftuar e Ilonit, mora vesh se sa përgatitje kërkon një sfilatë në tapetin e kuq. Kur vishem me fustan gala, ndjehem në mënyrë fantastike. Ndihem më e gjatë, e mbaj trupin më drejt, u buzëqesh të gjithëve dhe ndihem më e gjallë.

Tani e kuptoj se sa punë duhet të bëjë një ekip që të përgatisë figurat e famshme për tapetin e kuq në shfaqjet e çmimeve dhe premierat e filmave. Disenjatorët e modës, stilistët dhe asistentët e tyre bëjnë shumë përpjekje për të gjetur veshjet e përkryera. Por, ajo që me siguri nuk e dije është që veshja intime e përsosur është ajo që e bën fustanin të rrijë bukur. Gjithashtu, aksesorët janë të rëndësishëm, nga ata më seriozët deri në më ekstravagantët. Flokët duhet të duken ndryshe çdo herë në mënyrë që njerëzit ta shikojnë se ti përpiqesh për më tepër. Personat përgjegjës për makijazhin do të vendosin nëse duhet të kesh një pamje natyrale “pa makijazh” (për të cilën gjithsesi duhet një orë përgatitje),

ose një pamje me makijazh të rëndë me qerpikë falsë dhe konture të theksuara. Tani e di që duhet një “ushtri” e tërë e angazhuar për të gjitha këto. Duhet t’i vlerësoni të famshmit edhe për këtë, gjithashtu.



Kur shkoj në një event e veshur shumë bukur, kjo është falë Xhulia Perit, e cila është mikja ime më e mirë dhe stilistja ime prej tridhjetë vjetësh.

E takova Xhulian kur isha dyzet e tre vjeç. Kisha marrë diplomën e dytë master në Toronto dhe po përpiqesha të hapja studion time të nutricionit. Karriera ime si modele rezultoi e vlefshme, sepse agjencia, e cila kishte edhe një shkollë modelingu, më ofroi falas një zyrë nëse do të punoja si modele për ta dhe të jepja mësim në mbrëmje në shkollën e tyre. U mësoja kursanteve si të sflonin në pasarelë, teknika modelingu, të gjitha në nivel profesional dhe, për herë të parë, kisha zyrën time, nuk punoja në shtëpi. Ishte një fakt entuziazmues dhe ndiheshja profesioniste.

Vetëm pas një muaji më kërkuan që të bëhesha drejtoresha e shkollës së modelingut, sepse ajo që kishte atë pozicion ishte fare e çorganizuar. Ndërsa mua më njihnin që isha shumë korrekte dhe e përpiktë, gjë që ishte një avantazh i madh. U ofrova të jepja leksione edhe për gardërobën gjithashtu - isha mësuar të jepja këto lloj leksionesh që kur isha në Afrikën e Jugut, por nuk e kisha idenë se sa pak dija në fakt për këtë temë.

Sollën një eksperte dhe, sapo filluam të flisnim, e kuptova se nuk dija pothuajse asgjë për gardërobën. Ajo filloi të fliste për katër stinët dhe për ngjyra dhe tekstura të ndryshme... mbeta pa fjalë.

Kështu e njoha Xhulian. Sa për atë vetë, ajo shprehet kështu në lidhje me reagimin që pati kur më takoi për herë të parë:

- Takova një grua të bukur, e cila jepte mësim në shkollën e modelingut. Një modele e shkëlqyer, por që vishej shumë keq. Shumë keq.

Edhe pse tani vishem sipas modës më të fundit, nuk jam veshur kështu pjesën më të madhe të jetës sime. Kur isha fëmijë, shikoja mamanë që i qepte vetë të gjitha rrobat e saj dhe tonat po ashtu. Kur

u bëra adoleshente, mësova të qepja edhe unë në mënyrë që t'i bëja vetë rrobat e mia. Qepja pantallona dhe fustane. Mësova të qepja edhe kostum. Në fillim, punoja me kallëpe, por pastaj mamaja më dërgoi në një kurs për të mësuar sesi të prisja kallëpe në mënyrë që të bëja veshje si ato që dilnin nëpër revista, për të cilat nuk kishim kallëpe. Nëse doja të vishja rroba të modës së lartë, duhet të mësoja t'i bëja vetë.

Si profesioniste, ku zgjidhja veshjet për punë, zakonisht ndaloja te kostumet. Nuk vishja asgjë të ngushtë ose shumë të ngjitur pas trupit, sepse mendoja se nuk ishte e përshtatshme për punën që bëja si konsulente. Vishja kostume dhe kjo gjë më jepte besim në vetvete kudo që shkoja, sepse ndihesha mirë me këtë lloj veshjeje. Mendoja se dukesha jo vetëm elegante, por edhe një person tek i cili mund të kesh besim.

Ime bijë, Toska, më pyeste: “Do të veshësh përsëri një kostum gri apo përsëri një kostum blu?”. Sepse këto ishin zakonisht veshjet e mia.

Gjithmonë kam treguar kujdes për veten. Vetëm se nuk kam pasur shumë shije. Për fat të mirë, nuk e kisha kuptuar këtë. Nga ta kuptoja? Isha e rrethuar nga njerëz intelektualë dhe të gjithë ishim të fokusuar në punën kërkimore dhe bënim gjëra të mira për njerëzit e tjerë. Për shembull, mendonim si t'i ndihmonim që të vazhdonin të ishin të shëndetshëm. Na pëlqente shumë puna jonë. Unë isha më e veshur sipas modës sesa miqtë e mi intelektualë, kështu që, sigurisht, të gjithë kolegët mendonin se vishesha shkëlqyeshëm. Dhe unë kisha shumë besim në vetvete.

Pastaj takova Xhulian. Xhulia më tha se duhet të vishesha më mirë. Ajo këmbënguli që në vend të të gjitha atyre kostumeve, të mbaja vetëm një kostum që më rrinte më mirë dhe ishte me cilësi të mirë. Më premtoi se do të më ndihmonte për gardërobën. Kisha nevojë për ndihmën e saj, por nuk kisha mundësi financiare për ta paguar, kështu që ramë dakord që unë t'i ofroja konsultime për fushën e nutricionit në këmbim të këshillave të saj për stilin e veshjes. Mendoja se e ndihmova që të përmirësonte zakonet e të ushqyerit dhe ajo e pranon që e kam bërë këtë dhe vazhdoj ta bëj. Ndërkohë që edhe unë e di mirë se këshillat që më ka dhënë ajo, më kanë ndryshuar jetën.

Përpara se të njihja Xhulian, nuk dija sesi të vishesha për të pasur një ndikim maksimal tek të tjerët. Pasi njoha Xhulian, dukeshja po aq me vetëbesim në pamjen e jashtme, sa edhe atë të brendshme, dhe jam e bindur se suksesi që kam arritur në të dyja karrierat ka lidhje me këshillat që më ka dhënë ajo për mënyrën e të veshurit.

Në fillim, Xhulia erdhi dhe më pa rrobat që kisha në dollap dhe i hodhi pothuajse të gjitha. Mbeta vetëm me pak gjëra për të veshur.

- Tani, - më tha Xhulia, - duhet të blesh një kostum, dy bluza, një palë këpucë dhe një çantë. Në rregull?

- Nuk kam para të blej asgjë, - i thashë unë.

- Duhet të dukesh po aq mirë sa edhe klientët e tu, - më tha ajo.

Vazhdoja të kisha vështirësi financiare, kështu që vendosëm se mund ta bëja këtë gradualisht. Nuk kisha nevojë për shumë. Meqenëse klientët e mi më shikonin një herë në javë, nuk më duheshin veshje pune çdo ditë.

Herën e parë që veshja një kostum të mirë, me një prerje të shkëlqyer dhe me një material cilësor, u ndjeva më e sigurt në vetvete.

Ndërkohë që fitoja para, Xhulia këmbëngulte që të vazhdoja të investoja për gardërobën time, por problemi ishte se nuk kisha kohë për të dalë e për të blerë. Punoja jashtëzakonisht shumë dhe nuk kisha kohë për të dalë nëpër dyqane.

- Rezervo një orë për këtë gjë, - më këshilloi ajo.

Kishim aty afër disa dyqane dhe ajo u vetofrua që të shkonte në vendin tim, të zgjidhte disa gjëra që i mendonte të rëndësishme, si: një kostum, këpucë dhe bluza, veshje të përditshme dhe një pallto. Mund t'ia mbathja një vrap te dyqanet gjatë orarit të pushimit, t'i provoja të gjitha shpejt e shpejt, të paguaja për ato që do të vendosja dhe të kthehesha në zyrë. E bëja këtë një herë në dy muaj. Kështu e krijoi ajo gardërobën time.



Nëse dëshiron të jesh e veshur me shije, por të duket diçka e vështirë, merr shembullin tim dhe gjej një shoqe që ka stil. Zakonisht,

këtyre njerëzve u pëlqen të dalin nëpër dyqane. Kërkoji atij ose asaj që të dalë me ty, të zgjedhë disa veshje bazë, si dhe diçka të bukur për raste të veçanta. Duhet të të zgjedhë gjithashtu edhe aksesoret, si: vëthët, varëset, çantat e dorës, këpucët, getat. Të duhen veshje të plota. Kur të tjerët zgjedhin veshje për ty, ndihesh jo rehat dhe çuditshëm me to. Ashtu ndihesha edhe vetë gjithmonë, por kam marrë aq shumë komplimente sa e kam kuptuar se duhet të kem besim tek një person që ka më shumë stil sesa unë. Tregohu e gatshme të ndryshosh, të bësh gabime, të ndryshosh përsëri, derisa të gesh stilin që të përshtatet.

Gjatë pjesës më të madhe të jetës, nuk kam qenë e pasur dhe sërish ia kam dalë të vishem sipas modës, aq sa më lejonte talenti im. Mund t'i qepni vetë rrobat, ashtu siç kam bërë unë për shumë vite me radhë. Me një kallëp dhe një pëlhurë jo të kushtueshme mund të bësh një fustan të këndshëm. Sigurisht, duhet të kesh edhe një makinë qepëse. Ka dyqane të lira dhe dyqane me ulje, të tipit *outlet*. Ndonjëherë shkoja në dyqane me ndonjë shoqe, e cila më ndihmonte të blija veshje të ndryshme. Kur shkova në Toronto, një shoqe më çoi në një dyqan me ulje dhe më detyroi të blija një minifund 10 dollarë, megjithëse isha dyzet e dy vjeç. Më vinte aq turp, por të gjithëve u pëlqeu. Njerëzit besojnë se të duhen shumë para që të dukesh mirë. Por, duke folur si një person që ka pasur vështirësi financiare për shumë vite, mund të të them se duhet ta shikosh këtë gjë si një pjesë të shpenzimeve të tua vjetore të nevojshme. Njësoj si buxheti për prerjen e flokëve apo vizitat te dentisti. Nëse ke vetëm 500 dollarë për të shpenzuar dy herë në vit, atëherë mendo se ka periudha me ulje çmimesh, dyqane me produkte të përdorura dhe dyqane që japin veshje me qira, të cilat mund të të ndihmojnë me dy ose tre veshje që do të të përmirësojnë stilin e jetës dhe të punës. Ia vlen ta bësh këtë investim. Të duhet vetëm një plan.



Ja cili është plani im: dy herë në vit, mikja ime Xhulia vjen në apartamentin tim për të parë gardërobën. Gjithmonë përpiqemi të kufizohemi në ato që janë të domosdoshme, por pa lënë mënjane

cilësinë. Për ta bërë edhe ti këtë, nxirri të gjitha rrobat nga dollapi dhe sirtarët. Fut përsëri nëpër vende veshjet dhe aksesoret që të përshtaten dhe të cilat të pëlqejnë t'i veshësh. Riparo ato që janë për t'u riparuar.

Reduktimi i gardërobës vetëm në gjërat që i vesh, më ka bërë që ta kem kënaqësi të veshurën dhe jo një detyrë të përditshme. Ka shumë njerëz që lexojnë blogje mode dhe kalojnë orë të tëra duke blerë në dyqane ose duke provuar veshje të ndryshme. Thjesht u pëlqen ta bëjnë këtë gjë. Ndërsa mua, jo! Mua më pëlqen të vishem bukur, por nuk dua të kaloj shumë kohë gjatë ditës duke bërë këtë gjë. Prandaj, kontrollojmë aq shpesh rrobat që kam bashkë me Xhulian, duke hequr ato që nuk i kam veshur prej kohësh dhe duke i futur nëpër qese për t'i dhuruar te “*Dress for Success*”. Këto rroba janë të mira dhe të pastra; thjesht nuk më bëjnë më, por mund të bëjnë dikë tjetër mjaft të lumtur. Do të kisha dashur të kishte vende të tilla në Toronto, atëherë kur nuk kisha mundësi të blija rroba.

Nëse nuk kujdesesh në mënyrë të vazhdueshme për gardërobën tënde, ka shumë mundësi që gjysma e gjërave që ke të varura në dollap të jenë shumë të vogla, shumë të mëdha, duhen rregulluar ose thjesht nuk të përshtaten më. Gjëja më e rëndësishme është që rrobat të të rrinë mirë. Përndryshe, sapo bëhen shumë të mëdha, dukesh e veshur keq. Kur janë tepër të ngushta, ngjan akoma më keq.

Të dyja me Xhulian jemi të mendimit se disa artikuj bazë janë një fillim i mirë; këtyre mund t'u shtosh një byzylyk floriri ose një palë xhinse të modës dhe një palë çizme shik. Fillo me gjërat e thjeshta: veshjet e përditshme, si një palë xhinse të zeza që duken seksi me çdo gjë. Një palë streçe me lëkurë ekologjike, të cilat mund t'i veshësh me një pulovër ose me një këmishë me kopsa. Një pallto leshi të bukur ngjyrë gri ose një pardesy. Bluza të bukura me mëngë të shkurtra dhe vathë, të cilët mund t'i kombinosh me çdo gjë. Nëse do të fillosh të krijosh gardërobën tënde ose ke nevojë për ndonjë ndryshim të menjëhershëm, investo në një xhakëtë sportive ose serioze. Ajo do t'i japë një plus stilit të rrobave të tua dhe do të të bëjë të dukesh më e veçantë.

Më vonë, pasi të kesh siguruar gjërat bazë, bëhet shumë interesant shtimi i ngjyrave. Një pulovër me kopsa, ngjyrë jeshile ose rozë, ose

diçka që mund ta veshësh mbi gjithçka tjetër, ose një rrip të lezetshëm, të cilin mund ta përdorësh për të ndryshuar pamjen e pardesysë. Artikujt prej lëkure me cilësi të lartë janë një tjetër modalitet për të nxjerrë nga anonimati rrobat e vjetra dhe për të rënë në sy. Kur Xhulia filloi të merrej me gardërobën time, ajo e hoqi të gjithë koleksionin tim me çanta dore dhe e zëvendësoi me një çantë të vetme dhe të mirë lëkure. Edhe pse kisha një buxhet të kufizuar, ajo më mësoi se nuk është e rëndësishme sasia, por cilësia, kështu që mësova t'ia bëja qejfin vetes herë pas here me ndonjë gjë të mirë dhe të mos ndihesha fajtores për këtë. Në këtë mënyrë, mund të mbajmë një nivel të caktuar dhe të ndjekim modën në të njëjtën kohë, duke veshur rroba që i kemi prej ca kohe në gardërobë, pa u dashur që të blejmë gjithmonë shumë gjëra të reja.



Morali i këtij rrëfimi është ky: Nuk duhet të kesh stil patjetër që të vishesh mirë. Mjafton të kesh një shoqe me stil.



Ndonjëherë shoh edhe gra të tjera me flokë të bardhë si unë.

- Sa i bukur fustani yt! - më thonë ato.

- Edhe ju mund ta vishni një të tillë! - u them unë.

- Jo, nuk është e mundur, - vijojnë ato.

Shumë gra mendojnë se është e pamundur. Gra të moshës sime, gra të të gjitha moshave, të cilat as nuk e marrin mundimin të provojnë. I kuptoj shumë mirë, sepse edhe unë ashtu kam qenë dikur.

- Vish këtë! - më thoshte Xhulia.

- Jo, as që bëhet fjalë! - ia ktheja unë.

Përpiquesha ta kundërshtoja, por ajo nuk tundej nga e saja. Për çdo festë të ditëlindjes sime, ajo nuk më dëgjonte fare kur i thosha që një fustan ishte tepër i ngushtë ose tepër ekstravagant. Jam kaq e gëzuar që ka ngulur këmbë, sepse të gjitha fotografitë kanë dalë të mrekullueshme!

Prandaj tani them “po”, sepse mësova se, nëse e provoj diçka, ndoshta do të më pëlqejë. Dhe nëse nuk më pëlqen, çfarë pastaj? Janë thjesht rroba, në fund të fundit. Mund të provosh edhe rroba që s’të ngjisin, sepse nuk do të të duhet t’i veshësh për herë të dytë. Asgjë nuk është e përhershme.

Në të kaluarën nuk kam qenë aspak guximtare, ndërsa tani po. Meqenëse marr pjesë në shumë editoriale mode dhe seanca fotografike, ku tematikat janë tejet krijuese, shpesh



kombinohem në mënyra të guximshme dhe të papritura. Tani jam më kureshtare dhe më guximtare në lidhje me modën dhe e lë veten në duart e ekipit tim të modës së lartë. Shpesh e shikoj veten në pasqyrë përpara se të nisem për në ndonjë ceremoni dhe pyes veten: “Çfarë duhet të ketë pasur në mendje stilisti im? Thjesht nuk e kuptoj këtë pamje.”. Por, gëzohem nga reagimet që marr prej fotografëve, miqve dhe të huajve, të cilët më thonë se nuk dukem si shtatëdhjetecavjeçare dhe se guxoj shumë në lidhje me modën. Përse m’u desh kaq kohë e gjatë?

Sapo të marrësh një kompliment, do të ndjehesh shkëlqyeshëm, do të ecësh më drejt, do të buzëqeshësh më shumë dhe do të ndihesh rehat me stilin tënd të ri. Provoje!

KATËR

E DUA MAKIJAZHIN DHE MAKIJAZHI MË DO MUA

*Makijazhi mund të të ndryshojë pamjen fizike
dhe gjendjen tënde shpirtërore*



Të jesh një njeri mjaft tërheqës nuk do të thotë se duhet të kesh një pamje të jashtme të shpëlarë. Mua më pëlqen shumë makijazhi, sepse më ndryshon fytyrën: nga një kanavacë pa ngjyrë në një vepër arti. Kam njolla nga dielli, rrathë të zinj poshtë syve dhe, po, rrudha. Një krem pudër dhe një korrektor më bëjnë uniforme ngjyrën e lëkurës. Kam vetulla dhe qerpikë të rrallë dhe buzë të holla. Një laps vetullash më konturon bukur format e tyre. Makijazhi i syve m'i nxjerr sytë në pah dhe i bën të duken më të mëdhenj. Rimeli po ashtu. Qerpikët falsë më bëjnë të dukem magjepsëse dhe gati për tapetin e kuq. Konturi i buzëve i bën ato të duken më të plota dhe buzëkuqi u jep volum. Makijazhi më fsheh rrudhat, m'i bën sytë të duken më të mëdhenj dhe më nxjerr në pah mollëzat. Të gjitha këto janë arsye pse bëj makijazh.

Çdo “pamje” mund të jetë e ndryshme, nëse zgjedh ngjyra të ndryshme për qepallat e syve dhe buzët. Është mjaft argëtuese të eksperimentosh dhe ndihem shkëlqyeshëm kur shikoj rezultatet.



Kam bërë makijazh që kur isha adoleshente. Ishin vitet '60 dhe studioja Tuixhin (Twiggy¹) nëpër revista. Më duhej që të bëja shumë punë që të kopjoja imazhin e saj: një vijë e zezë e zgjatur deri te bishti i syve, qerpikë falsë, të dendur në qepallë dhe të rrallë në pjesën e poshtme; zakonisht i lyeja edhe qerpikët e poshtëm. Zgjaste nja një orë, por kënaqesha shumë. Të gjitha motrave na pëlqente ky lloj makijazhi, sepse na bënte të dukeshim magjepsëse dhe të modës. Kur na shikonte babi, na thoshte: “Është shumë.”.

Problemi i modës është që, për të mbajtur ritmin e saj, duhet të ndryshosh vazhdimisht. Kështu, kur erdhi përsëri në modë makijazhi natyral, u desh të ndryshoja krejtësisht stilin e makijazhit. Në vitet gjashtëdhjetë, sipas stilit të Tuixhit, donim vetulla shumë të holla. Arrita t'i shkulja aq mirë me piskatore vetullat e mia sa nuk më dolën më. As nuk kisha shumë, të them të drejtën! Por, i shkula të gjitha ato që kisha.

Menjëherë sapo ndryshoi stili, m'u desh të mësoja si t'i mbushja.

Ende vazhdoj t'i mbush! Kjo është kënaqësia e makijazhit. Nuk marr vesh shumë nga vizatimi i vetullave, por të paktën, në këtë mënyrë, kam vetulla!



Tani jam shtatëdhjetë e një vjeç dhe ende më pëlqen të vishem për tapetin e kuq ose për sfilata në podiumet e spektakleve të modës. Por, nuk vishem kështu çdo ditë! Shumicën e kohës, kur jam në shtëpi, nuk bëj makijazh, thjesht pastroj mirë fytyrën dhe vendos balsam në buzë. Nuk bëj makijazh as kur nxjerr qenin shëtitje, as kur punoj në kompjuter, apo marr nipërit nga shkolla. Bëj makijazh kur dal për një drekë në restorant, kur takohem me shoqërinë ose kur shkoj në ndonjë takim.

¹ Dame Lesley Lawson DBE është modele, aktore dhe këngëtare angleze, e njohur gjerësisht me emrin Twiggy. (shën. i përkth.)

Rituali im i makijazhit fillon me një fytyrë të pastër dhe të hidratuar. Mënyra sesi kujdesem për lëkurën është e thjeshtë. Përdor një larës fytyre në shtëpi dhe vetëm ujë e sapun kur udhëtoj. Aplikoj kremin e syve, pastaj një krem me faktor mbrojtës të paktën SPF15 në ditët me diell. Në mbrëmje, pastroj fytyrën që të largoj çdo gjurmë makijazhi dhe pastaj aplikoj një krem sysh dhe një krem fytyre për natën.

Është zgjedhja jote nëse bën makijazh apo jo, por përdor gjithmonë krem për mbrojtje nga dielli! Nëse i kapërcen masat mbrojtëse nga dielli, do të kesh probleme. Nuk mund të them dot se sa shumë femra përdorin lloj-lloj trajtimesh për fytyrën dhe pastaj ekspozohen në diell, një gabim që unë e quaj “sabotimi i lëkurës”. Vendimi më i mirë që mund të marrë dikush është të mbrojtë lëkurën kur del në diell, duke e lyer me krem ose duke mbajtur një kapelë.



Kur nuk marr pjesë në ceremony me tapet të kuq, e bëj vetë makijazhin. Por, nëse e bëj vetë për tapetin e kuq, do të dukem krejt e shpëlarë. Kur makijazhi bëhet nga një profesionist, rezultati është i shkëlqyer. Ndonjëherë qepallat m’i lyejnë me ngjyrë jeshile, ndonjëherë me ngjyrë floriri në bishtat e syve. Diçka vërtet e veçantë për një grua në të shtatëdhjetat. Komentet në rrjete sociale janë pozitive, kështu që unë vazhdoj të eksperimentoj. Komentet si: “e fortë”; “plot zjarr”; “GOAT” që do të thotë “*Greatest of All Time*” (më e mira e të gjitha kohërave); dhe “OG” për “Original Gangster” (*Gangstere origjinale*). Kjo e fundit është me të vërtetë tërheqëse.

Më duhen vetëm dhjetë minuta kur e bëj vetë makijazhin. Grimuesve u duhet rreth një orë. Edhe nëse do të kisha një orë në dispozicion, përsëri nuk do të mundesha të krijoja pamjen e duhur, sepse nuk e kam talentin e duhur. Grimuesit janë artistë! Unë merrem me punë kërkimore dhe nuk e kam talentin për të bërë atë çka bëjnë artistët. Por, edhe njerëzit që nuk janë artistë mund të bëjnë makijazh të bukur nëse kanë disa mjete të thjeshta dhe mësojnë sesi t’i përdorin. Njoh një grimuese profesioniste, e cila i mban të gjitha bojërat dhe mjetet në një valixhe. Njëzet e katër

kilogramë mjete dhe produkte makijazhi, të cilat i mban me vete kur udhëton me avion. Dhe gjithmonë i duhet të paguajë tarifë shtesë për peshën, por i duhet patjetër ai kilogram më tepër mjetesh. Sepse kjo është puna e saj.

Jam me fat që kam një mike si Xhulia në rolin e regjisores artistike atëherë kur duhet të vishem për një event. Dhe vendosim së bashku se kush do të jem atë mbrëmje. Ajo mendon për gjithçka që mund të bëjë që unë të dal në pah.



Si të m'i bëjnë flokët? Si të më bëjnë makijazhin? A do të dukem e freskët? Të m'i bëjnë edhe sytë të theksuara fort? Të më lyejnë me buzëkuq të ndezur? Ajo mund të kërkojë ngjyrë floriri, ngjyrë vjollcë ose bojë qielli. Mendon për ceremoninë ku do të shkojmë, sepse personazhi krijohet për një ngjarje të caktuar. Është premierë filmi? Është një prezantim libri? Është ndonjë aktivitet bamirësie? Pastaj i përvishet punës. Është si një festë me kostume.



Kur u zgjodha si imazh për *CoverGirl* në moshën gjashtëdhjetenëntëvjeçare, ishte një surprizë e madhe dhe fantastike. Kisha marrë pjesë edhe më parë në fushata për makijazhe, por në asnjërën prej tyre nuk kisha qenë modelja kryesore. Isha shumë e ngazëllyer. Tani Amerika mund të shikonte se makijazhi ishte i përshtatshëm për të gjitha moshat. Nuk më kanë kërkuar asnjëherë që të dukesh më e re, as nuk e kam ndjerë nevojën që të fsheh moshën. Jam shumë e lumtur që jam shtatëdhjetë e një vjeç! Jam shumë e kënaqur që mund t'u tregoj njerëzve se sa mirë mund të dukemi në këtë moshë. Makijazhi mund të na përmirësojë pamjen e jashtme. Le të përfitojmë nga kjo gjë.